

**KOMBET E
BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen
Penale të Personave Përgjegjës për
Shkelje të Rënda të së Drejtës
Humanitare Ndërkombëtare të Kryera
në Territorin e ish-Jugosllavisë prej
Vitit 1991

Lënda Nr. IT-04-84bis-PT

Data: 29 nëntor 2010

Originali: anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE II

Para: Gjykatësit Bakone Justice Moloto, Gjykatës Paragjyqësor

Sekretari: Z. John Hocking

Vendim: 29 nëntor 2010

PROKURORI

kundër

**RAMUSH HARADINAJT
IDRIZ BALAJT
LAHI BRAHIMAJT**

PUBLIK

**VENDIM MBI MOCIONIN PËR ZGJATJEN E AFATIT PËR DORËZIMIN E
DOSJES PARAGJYQËSORE, LISTËS SË PROVAVE MATERIALE DHE LISTËS
SË DËSHMITARËVE**

Zyrës së Prokurorit:

Z. Paul Rogers

Avokatëve të Mbrojtjes:

Z. Ben Emmerson QC dhe Z. Rodney Dixon për Ramush Haradinajn
Z. Gregor Guy-Smith dhe Zj. Colleen Rohan për Idriz Balajn
Z. Richard Harvey dhe Z. Paul Troop për Lahi Brahimajn

KJO DHOMË GJYQËSORE e Tribunalit Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të Të Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991 (“Tribunali”).

PASI KA MARRË “Mocion për zgjatjen e afatit për dorëzimin e dosjes paragjyqësore, listës së provave materiale dhe listës së dëshmitarëve”, dorëzuar konfidencialisht më 26 nëntor 2010 (“Mocion”);

DUKE MARRË SHËNIM se gjatë konferencës për gjendjen mbajtur më 23 shtator 2010, Gjykatësi Paragjyqësor urdhëroi Prokurorinë që brenda datës 30 nëntor 2010 të dorëzonte dosjen paragjyqësore, listën e dëshmitarëve të vet dhe listën e provave materiale bazuar në Rregullën 65 *ter* të Rregullores së Procedurës dhe Provave (“Rregullorja”);¹

DUKE MARRË SHËNIM se në Mocion Prokuroria i kërkoi Gjykatësit Paragjyqësor që të miratonte një zgjatje treditore deri më 3 dhjetor 2010, dhe duke e përfshirë këtë datë, për dorëzimin prej Prokurorisë të dosjes paragjyqësore, listës së dëshmitarëve dhe të provave materiale;²

DUKE MARRË SHËNIM se Balaj dhe Brahimaj nuk kanë kundërshtim ndaj kërkesës së Prokurorisë³ dhe Haradinaj nuk ngre kundërshtime, me kusht që Mbrojtjes ti jepet kohë e arsyeshme dhe e mjaftueshme për t’iu përgjigjur Dosjes Paragjyqësore;⁴

DUKE MARRË PARASYSH se miratimi i zgjatjes së afatit kërkuar prej Prokurorisë është në interes të drejtësisë;

BAZUAR në Nenin 127(A) të Rregullores,

MIRATON Mocionin **DHE URDHËRON** që Prokuroria të dorëzojë më 3 dhjetor 2010 ose brenda kësaj date, Dosjen e vet Paragjyqësore dhe listën e dëshmitarëve dhe të provave materiale në bazë të Rregullës 65 *ter*.

¹ Konferencë për Gjendjen, 23 shtator 2010. T.6.

² Mocion, para 4.

³ Letërkëmbim elektronik i 26 nëntorit 2010.

⁴ Letërkëmbim elektronik i 28 nëntorit 2010

Përpiluar në anglisht dhe frëngjisht; teksti në anglisht ka përparësi.

/nënshkruar në origjinal/

Gjykatës Bakone Justice Moloto

Gjykatës Paragjyqësor

Sot, më datën 29 nëntor 2010.

Në Hagë

Holandë

[Vula e Tribunalit Ndërkombëtar]